



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRAJNIMIN E TRAJNERËVE NË POLICINË E SHTETIT PËR ÇËSHTJEN E DIVERSITETIT**

*8 tetor 2012*

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Burgaj,  
Drejtor i Qendrës së Formimit Policor Hoxha,  
Të nderuar të ftuar,  
Zonja dhe zotërinj,

Si kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam shumë i kënaqur që ndodhem sot me ju, për hapjen e këtij trajnimi të trajnerëve për diversitetin.

Ky trajnim bazohet në bashkëpunimin e shkëlqyer mes Policisë së Shtetit shqiptar dhe Prezencës, një bashkëpunimin për të cilin kujdesemi së tepërmi, pasi përfshin fusha kyçe për përparimin e reformave të vendit tuaj dhe, ç'është më e rëndësishmja, për të ardhmen e tij si një shoqëri evropiane demokratike moderne.

Trajnimi që na ka mbledhur sot pasqyron qëllimin tonë të përbashkët për ta trajtuar diversitetin si çështje parësore të Policisë së Shtetit.

Ky trajnim bëhet pas një seminari strategjik të suksesshëm, që u zhvillua për drejtuesit e policisë, në muajin qershor.

Trajnimi është, gjithashtu, një hap praktik në zbatimin e mandatit të Prezencës për promovimin e të drejtave të njeriut dhe ofrimit të ndihmës për policinë.

Në shpresojmë që, përmes trajnimit të instruktorëve të Qendrës së Formimit Policor, diversiteti të futet në kurrikulën e formimit policor e të arrijë te çdo rekrut. Ne duam që kjo të jetë e qartë dhe e qëndrueshme.

Kështu, diversiteti do të bëhet një përbërës thelbësor i punës së përditshme të policisë në Shqipëri, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare të policisë.

Thënë shkoqur: kjo nuk është një çështje e dorës së dytë dhe as çështje që u përket vetëm veprimtarëve të të drejtave të njeriut.

Respektimi dhe mbrojtja e diversitetit është pjesë e konventave të ndryshme ndërkombëtare.

Ai përbën, gjithashtu, një angazhim të OSBE-së, për të cilin kanë rënë dakord që të 56-a Shtetet pjesëmarrëse, përfshirë Shqipërinë.

Është një vlerë e përbashkët që na lidh.

Diversiteti ka të bëjë me marrëdhëniet midis shtetit dhe kulturave të ndryshme, si dhe midis shtetit dhe individëve.

Thënë thjesht, do të thotë pranimi i veçantisë të çdo individi, pavarësisht racës, ngjyrës, besimit, etnisë, gjinisë, orientimit seksual, e të tjera.

Gjithashtu, më duhet të theksoj se kjo nuk do të thotë thjesht të pranosh ekzistencën e dallimeve.

Më shumë se kaq: kërkohet një kornizë kushtetuese dhe institucionale dinamike, që t'i lejojë këto dallime të kontribuojnë në shoqëritë tona demokratike.

Prandaj, respektimi i diversitetit do të thotë një politikë të tolerancës zero ndaj çdo lloji diskriminimi.

Së fundmi, është një çështje e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së barabartë të të gjithë njerëzve.

Këto janë parime themelore të demokracive moderne, të cilat marrin një domethënie shumë të prekshme kur bëhet fjalë për policinë.

Shumë shpesh, punonjësit e policisë janë fytyra e dukshme e shtetit.

Oficerët e policisë janë kontakti i parë i qytetarëve kur këta të fundit ballafaqohen me një problem lidhur me të drejtat e tyre, një nga më themeloret e të cilave është siguria.

Siguri do të thotë, gjithashtu, që çdo individ të ndjehet i mbrojtur dhe të trajtohet drejt kur ndërvepron me punonjësit dhe punonjëset e policisë.

Prandaj, është jetike që policia të përdorë të gjitha fuqitë ligjore për të luftuar veprimet e motivuara nga racizmi, ksenofobia dhe, në përgjithësi, mungesa e tolerancës ndaj pakicave ose grupeve të tjera më të dobëta.

Fatkeqësisht, në këto kohë kufizimesh ekonomike, veprime të tilla mund të shtohen. Për këtë arsye, është akoma më e rëndësishme që policia (dhe të gjitha institucionet) t'i kushtojë të gjitha përpjekjet parandalimit të krimeve të urrejtjes dhe të reagojë me vendosmëri, në përputhje me ligjin.

Pikërisht për këtë, sjellja diskriminuese e vetë policisë është e papranueshme. Ajo dëmton kohezionin dhe stabilitetin shoqëror, si dhe legjitimitetin e policisë.

Nuk duhet të harrojmë që parimi mbi të cilin ndërtohet policia është t'u shërbejë qytetarëve, duke garantuar sigurinë e tyre.

Për shembull, një hap në mbështetjen e diversitetit mund të ishte integrimi më i mirë i pakicave në rangjet e policisë, në të gjitha nivelet. Kjo do të ishte një masë pozitive për rritjen e besimit.

Drejtori i Përgjithshëm Burgaj,  
Të nderuar të ftuar,

Dua të falenderoj Kolegjin e Policisë Skoceze për mbështetjen që ka dhënë me ofrimin e ekspertizës në trajnim.

Gjithashtu, dua t'ju nxis të përfitoni sa më shumë nga ekspertiza e trajnerit tuaj me përvojë dhe, më pas, t'ua përçoni këtë dije oficerëve të tjerë të policisë.

Përpara se ta mbyll fjalën time, do të doja t'ju thosha atë që i thashë Drejtorit të Përgjithshëm Burgaj pak më parë. Do të doja të përgëzoja Shqipërinë për organizimin e suksesshëm të Takimeve të Vjeshtës të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, gjatë ditëve të shkuara, që sollën në Tiranë deputetë të shumë vendeve të rajonit të OSBE-së. Ishte një veprimtari pozitive dhe e frytshme. Shqipëria mund të krenohet me të drejtë me këtë arritje.

Në këtë kontekst, edhe vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Laberto Zannier, ishte shumë produktive. Ambasadori Zannier u takua me zyrtarët më të lartë të shtetit, si dhe me Avokatin e Popullit.

Në këtë kuadër, do të doja ta shfrytëzoja këtë mundësi për të lavdëruar e falënderuar nga zemra Policinë e Shtetit për punën tuaj shumë profesionale në ofrimin e sigurisë gjatë takimeve të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe lëvizjeve të delegacionit të Sekretarit të Përgjithshëm.

Dhe tani, ju uroj një trajnim të suksesshëm dhe frytdhënës, gjatë tri javëve në vijim. Ju faleminderit!

**Fund**